



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 130

Tiranë – E premte, 20 gusht 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 481, datë 30.7.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim të detyruar”, të ndryshuar..... 13431
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 30.7.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 164, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”..... 13431
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 490, datë 30.7.2021	Për kryerjen e pagesës së dozave të vaksinave dhe të pagesave respektive, që rrjedhin nga marrëveshja e nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin, ndërmjet <i>Pfizer Export B.V.</i> dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, të miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, dhe me ligjin nr. 3/2021..... 13433
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 117/5, datë 18.8.2021	Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtim sistemim i rrugës Gjykatë – Akademia e Marinës – 7 pallatet, faza I”..... 13433
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 31/7, datë 19.8.2021	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Restaurimi dhe rijetësimi i ‘Sarajet e Libohovitëve’, Muzeu Etnografik i Tiranës”..... 13434
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 33/5, datë 19.8.2021	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Restaurimi dhe rijetësimi i ‘Banesa e Toptanasve’, Muzeu Etnografik i Tiranës”..... 13436

**VENDIM****Nr. 481, datë 30.7.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E
FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E NDËRTIMIT DHE TË
RIKONSTRUKSIONIT TË
INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, NË
ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR
ZHVILLIM TË DETYRUAR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shifra “... 12 385 386 283 (dymbëdhjetë miliardë e treqind e tetëdhjetë e pesë milionë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 13 180 466 653 (trembëdhjetë miliardë e njëqind e tetëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH ...”.

2. Në pikën 2/a, shifra “... 3 975 401 851 (tre miliardë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e katërqind e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 4 770 482 221 (katër miliardë e shtatëqind e shtatëdhjetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e një) lekë pa TVSH ...”.

3. Në pikën 3.1, shifra “... 1 331 932 076 (një miliard e treqind e tridhjetë e një milionë e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH ...”, zëvendësohet me “... 1

611 987 454 (një miliard e gjashtëqind e njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ...”.

4. Në pikën 3.1/a, shifra “... 897 566 799 (tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 1 177 622 177 (një miliard e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ...”.

II. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM**Nr. 482, datë 30.7.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 164, DATË 19.2.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E
ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË
NJËSINË ADMINISTRATIVE DURRËS,
BASHKIA DURRËS, DHE ÇAKTIMIN E
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI
NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjeve “iii” e “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13, dhe të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 164, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, harta dhe koordinatat zëvendësohen përkatësisht me hartën dhe koordinatat, që i bashkëlidhen këtij vendimi;

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:


“2. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese për këtë zonë, për ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike e kritike.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Durrës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe



**VENDIM****Nr. 490, datë 30.7.2021**

**PËR KRYERJEN E PAGESËS SË
DOZAVE TË VAKSINAVE DHE TË
PAGESAVE RESPEKTIVE, QË
RRJEDHIN NGA MARRËVESHJA E
NËNSHKRUAR PËR PRODHIMIN DHE
FURNIZIMIN, NDËRMJET *PFIZER
EXPORT B.V.* DHE MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE, MINISTRIT TË SHETIT PËR
RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË
SHËNDETIT PUBLIK, TË MIRATUAR
ME AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË
18.1.2021, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, DHE ME LIGJIN
NR. 3/2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, të aktit normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik”, të miratuar me ligjin nr. 3/2021, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryerjen nga Instituti i Shëndetit Publik të pagesave, të përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, të miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, dhe me ligjin nr. 3/2021, në vlerën 2 447 233.68 (dy milionë e katërqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e tre pikë gjashtëdhjetë e tetë) euro, të konvertuara sipas kursit zyrtar të këmbimit në ditën e pagesës.

2. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e saj të miratuar për vitin 2021, në llogarinë ekonomike 6050000 (produkti 91305AH) të programit “Shërbime të shëndetit publik” (07450), i shtohet ekuivalenti në lekë i shumës prej 2 447 233.68 (dy milionë e katërqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e tre pikë gjashtëdhjetë e tetë) euro, për kryerjen e pagesës së dozës së vaksinës nga kompania *Pfizer Export B.V.*

3. Fondi, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Shëndetit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Erion Braçe****KËRKESË****Nr. 117/5, datë 18.8.2021****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën “Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga projekti ‘Ndërtim sistemim i rrugës Gjykatë – Akademia e Marinës – 7 pallatet, faza I’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogarit, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për



përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Vlorë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 545,150 (pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Erlis Hereni

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
Klodiana Guci

LISTA EMËRORE E PRONARIT PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.595, DATË 31.08.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIM SISTEMIMI I RRUGËS GJYKATË-AKADEMIJA E MARINËS-7 PALLATET, FAZA I”.

Nr.	Emër Atesë Mbiemër	Z.K.	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip.	Sip.e shpronësuar/ m²	Çmimi në lekë/ /m²	Vlera totale për shpronësim	Shënime
					Totale /m²				
1	Bj Sudiku	8602	36/277	truall		50	10,903	545,150	Konfirmuar nga ASHK.
Vlera totale						50		545,150	

Shënime:

1. Për token “Truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga Vendimi nr. 89, datë 03.02.2016 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

KËRKESË Nr. 31/7, datë 19.8.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Restaurimi dhe rrijetësimi i ‘Sarajet e Libohovitëve’, Muzeu Etnografik i Tiranës”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, si dhe bazuar në VKM-në nr. 138,

datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi”, konfirmuar me çmim mesatar shitblerjesh nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore, Tirana Veri, me shkresën nr. 2482/5 prot., datë 17.8.2021, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 505 843 802.6 (pesëqind e pesë milionë e tetëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e dy pikë gjashtë) lekë.

KRYETAR I
KOMISIONIT TË POSAÇËM TË
SHPRONËSIMEVE
Klodiana Guci



LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI “RESTAURIMI DHE RIJETËSIMI I ‘SARAJET E LIBOHOVITËVE’,
MUZEU ETNOGRAFIK I TIRANËS”

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pas.	Sip. përgj. Truall (m²)	Sip. prekur truall (m²)	Çmimi për truall (lek/m²)	Vlera trualli i prekur (lek)	Sip. e gjurmës së objektit, sipas kartelës (m²)	Sip. e përgj. ndërtimi e objektit, sipas kartelës (m²)	Sip. prekur objekt (m²)		Çmimi për objekt banimi (lek/m²)	Vlera sip. e prekur objekt shërbimi, me situacion (lek)	Vlera sip. e prekur objekt banimi (lek)	Vlera e përgj. truall + objekt (lek)	Konfirmim nga ZVRPP-ja Tiranë dhe ASHK-ja Tiranë	Shënime
										Sip. shërbimi (m²)	Sip. banimi (m²)						
1	Shtet	8150	1/514	50.10	50.10	-	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	-	Shkresa nr. prot. 33660/1, datë 13.12.2017, ZVRPP-së	Mungon seksioni E+D i kartelës
2	Leila Shefqet Libohova	8150	1/518	859	859.00	66,969.00	57,526,371.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	57,526,371	Shkresa nr. prot. 958/1, datë 26.1.2018, ZVRPP-së	Ne përshkrimin e veçantë ka shënimin: Ka diferencë dokument-fakt 71 m2. Sipas dokumentacionit ka 930 m2
3	Shtet	8150	1/97	114.70	114.70	-	-						0.00	0	-	Shkresa nr. prot. 33660/1, datë 13.12.2017, ZVRPP-së	
4	BP. Mirashi, Libohova	8150	1/205	2489	2489	66,969.00	166,685,841.00	811	1622		1622.00	173,632.30	-	281,631,590.60	448,317,431.60	Shkresat nr. prot. 958/1, datë 26.1.2018, ZVRPP-së dhe nr. prot. 2482/5, datë 17.8.2021, e ASHK-së, Drejt. Vend., Tirana Veri	Në përshkrimin e veçantë ka shënimin: “Banesë 2-katëshe, me 31 dhoma”.
SHUMA					3512.8						1,622				505,843,802.60		

SHËNIM:

1. Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen me shkresat nr. prot. 33660/1, datë 13.12.2017 dhe nr. prot. 958/1, datë 26.1.2018, të ZVRPP-së Tiranë.
2. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.
3. Për objektet me funksion banimi, çmimi për llogaritje është marrë çmimi mesatar për objekt banimi, vënë në dispozicionin tonë me shkresën nr. prot. 2482/5, datë 17.8.2021, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tirana Veri.

**KËRKESË****Nr. 33/5, datë 19.8.2021****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Restaurimi dhe rijetësimi i ‘Banesa e Toptanasve’, Muzeu Etnografik i Tiranës”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, si dhe bazuar në VKM-në nr. 138,

datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi”, konfirmuar me çmim mesatar shitblerjesh nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore, Tiranë Veri, me shkresën nr. 2482/5 prot., datë 17.8.2021, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 178 694 456 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

KRYETAR I
KOMISIONIT TË POSAÇËM TË
SHPRONËSIMEVE
Klodiana Guci



LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI “RESTAURIMI DHE RIJETËSIMI I ‘BANESA E TOPTANASVE’,
MUZEU ETNOGRAFIK I TIRANËS”

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. pas.	Sip. e përgj. truall (m²)	Sip. e prekur truall (m²)	Çmimi për truall (lek/m²)	Vlera truall i prekur (lek)	Sip. e gjurmës së objektit, sipas kartelës (m²)	Sip. e përgj. ndërtimi e objektit, sipas kartelës (m²)	Sip. prekur objekt (m²)		Çmimi për objekt banimi (lek/m²)	Vlera sip. e prekur objekti shërbimi, me situacion (lek)	Vlera sip. e prekur objekt banimi (lek)	Vlera e përgj. truall + objekt (lek)	Konfirmim nga ASHK-ja Tiranë	SHËNIME
										Sip. shërbimi (m²)	Sip. banimi (m²)						
1	BP Këllezi, Kosova, Zajmi, Hoxholli, Permeti, Podgorica, Kazazi, Pashollari, Pirgu, Llapaj, Cara, Skenderi, Stermasi, VI&VI sh.p.k.	8150	1/65	1569	1569	66969	105074361	424.00	424.00	0.00	424.00	173632.30	0.00	73620095.2	178694456	Konfirmohet me shkresat nr. prot. 2622/1, datë 27.4.2020 dhe 2482/5, datë 17.8.2021, të ASHK-së, Drejtoria Vendore, Tiranë Veri	Në seksionin D të kartelës së pasurisë ka shënimin: “Në bazë të kontratës së nr. 683/204, datë 30.3.2009, notere Alma Poshi, kjo pasuri është me qira për 10 vjet.
VLERA TOTALE PARAPRAKE					1569										178694456		

SHËNIM:

- Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen me shkresën nr. prot. 2622/1, datë 27.4.2020 të ASHK-së, Drejtoria Vendore, Tiranë Veri.
- Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.
- Për objektet me funksion banimi, çmimi për llogaritje është marrë çmimi mesatar për objekt banimi vënë në dispozicionin tonë me shkresën nr. prot. 2482/5, datë 17.8.2021, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tiranë Veri.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë